



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:063926
Datë: 26.02.2019
Numri i dokumentit: 00233166

P. nr. 1344/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-me gjyqtaren e vetme gjykuese Fitore Daci dhe zyrtarin ligjor Burim Haxhidema, në lëndën penale kundër të pandehurit V.Sh nga Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2, lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II. Nr 1592-3/2018 të datës 17 tetor 2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më 06.02.2018 në prani të Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, të pandehurit V.Sh, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V.Sh, nga i ati ... dhe e ëma..., e gjinisë..., i lindur me ... në fshatin ... Komuna Ferizaj, i martuar, baba i pesë fëmijëve, kuzhinier, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r

Se me dt. 14.07.2018, rreth orës 19:20, në fshatin Pleshinë, Komuna Ferizaj, i mllefosour për shkak se ditë më parë ia rrahin djalin, posa takohen , pasnjë fjalosje, me dashje që të i shkakton lëndimet trupore, i godet fillimisht me grushte të dëmtuarit A.C dhe Sh.C, pastaj merr një guri , mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit truporë, me të cilin godet në kokë të dëmtuarin Sh.C , me ç'rast të njëjtit pësojnë lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nenit 4,7,17,21,41,42,49,50,51,74,75 dhe 76 të KPRK-së dhe nen. 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe të njëjtin dënim urdhëron që mos të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 /një/ viti, pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit A.C dhe Sh.C nga fshati..., Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzet/ euro si dhe në emër te shpenzimeve te procedurës penale shumën prej 20 € /njëzet/ euro dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore, në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit.

Obligohet i pandehuri të paguaj shumën prej 30€ /tridhjetë euro/, në emër të kompensimit të Viktimave të krimit, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II. Nr 1592-3/2018 të datës 17 tetor 2018 ndaj të pandehurit V.Sh për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2, lidhur me par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

Duke vepruar sipas kësaj akuze, në këtë Gjykatë me 26.12. 2018 është mbajtur shqyrtimi fillestar sipas dispozitave të nenit 245 të KPPK-së.

Pranimi i fajësisë nga i pandehuri

I pandehuri në shqyrtimin fillestar të dt.26.12.2018 nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2, lidhur me par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë me aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Me dt. 06.02.2019, Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë, në të cilin shqyrtim i pandehuri V.Sh deklaron se e ndien veten fajtorë për veprën penale që e ngarkon aktakuza e prokurorisë.

Ka deklaruar se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka kuptuar natyrën e kësaj veprë, pranimin e fajit e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ka kërkuar nga gjykata që të i shqiptoj një sanksion penal më të butë pasi është penduar për atë që ka bërë dhe i premtton gjykatës që më nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtimin gjyqësorë konstatoi se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe

provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë siç janë: Akt-ekspertimi mjeko-ligjorë në bazë të dokumenteve të çështjes lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore të A.C dhe Sh.C nga dr. N.H I dt. 20.09.2018 si dhe fotografitë e të dëmtuarve bërë në Qendren Emergjente në Ferizaj dhe shkresat tjera në lëndë dhe me këtë janë përmbushur te gjitha kushtet ligjore te parapara në nenin 248 te KPPK-së, dhe në këtë mënyrë shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 326 të KPPK-së.

Fjala përfundimtare

Në fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, deklaroi se pasi qe i pandehuri në këtë fazë të procedurës pranoi fajësinë për veprën penale dhe ky pranim është bërë konform nenit 248 dhe mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, andaj i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe të i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj.

Av.B.S në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, i bashkëngjitet ndjekjes penale me propozimin që i pandehuri të merr një dënim të paraparë me ligj në të cilin gjykata të i merr për bazë rrethanat rënduese si në vijim, moshën e të pandehurit në krahasim me atë të dëmtuarve, pajtimin paraprak të familjeve para se të ndodhe rasti në fjalë dhe mos respektimi i marrëveshjes nga ana e të pandehurit, gjithashtu paraqesim kërkesë pasurore- juridike të cilën do ta bëjmë bëjmë në procedurë civile.

I dëmtuari A.C me përfaqësuesin ligjorë, prindin e tij, në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tyre.

I dëmtuari Sh.C me përfaqësuesin ligjorë, prindin e tij, në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tyre.

I pandehuri V.Sh, në fjalën përfundimtare deklaroi se jam tejet i penduar për veprën penale, i premtoj gjykatës se nuk do të ndodhë me asnjë zënkë mes meje dhe palëve të dëmtuara dhe kërkon nga gjykata të i shqiptojë një dënim sa më të butë sepse është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Gjyqtarja e vetme gjykuese po ashtu konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2, lidhur me par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së për të cilën veprën e pandehurit është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i dënimit për të pandehurin

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marr për bazë pranimin e fajësisë nga i njëjti, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, baba i pesë fëmijëve, mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh faktin se vepra e tillë penale është e përhapur mjaft dhe paraqet një rrezikshmëri të caktuar shoqërore.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke i shërbyer preventivës speciale-që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej veprën penale.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe ato të procedurës penale, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1344/2018, më datë 06.02.2019

Zyrtari ligjor

Gjyqtarja

Burim Haxhidema

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në drejtim të sanksionit penal.